

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.**

**Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

## **Pasqyra e lëndës**

	Faqe
Raporti auditorëve të pavarur	i-ii
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2012	1
Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012	2
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	5-25



**KPMG Albania Sh.p.k**  
"Dëshmorët e Kombit" Blvd  
Twin Towers Buildings  
Building 1, 13th floor  
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524  
+355(4)2274 534  
Telefax +355(4)2235 534  
E-mail al-office@kpmg.com  
Internet www.kpmg.al

## Raporti i audituesve të pavarur

Pronarëve të  
SICPA Security Solutions Albania Sh.p.k

Tiranë, 29 mars 2013

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të SICPA Security Solutions Albania Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2012, pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndryshimeve në kapital dhe flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

### *Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.



*Opinion*

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2012, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

*KPMG Albania Shpk*

KPMG Albania Sh.p.k.  
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.  
Twin Towers Buildings,  
Building 1, 13th floor  
Tirana, Albania

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.**  
**Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2012**

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktivët afatgjatë</b>			
Aktivët afatgjatë materiale	6	806,574,262	581,655,360
Aktivët afatgjatë jomateriale	7	117,710	163,275
Aktivët tatimore të shtyra	8	14,574,551	22,415,065
		<b>821,266,523</b>	<b>604,233,700</b>
<b>Aktivët afatshkurtra</b>			
Inventari	9	182,026,267	192,867,419
Parapagime dhe të tjera të arkëtueshme	10	172,014,183	168,618,659
Tatim fitimi i parapaguar	11	771,250	171,250
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	12	22,948,433	11,541,791
		<b>377,760,133</b>	<b>373,199,119</b>
Aktivët afatgjatë të mbajtura për shitje	13	44,281,515	-
		<b>422,041,648</b>	<b>373,199,119</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>1,243,308,171</b>	<b>977,432,819</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali i nënshkruar		6,800,000	6,800,000
Humbje të akumuluar	14	(308,733,609)	(227,941,774)
		<b>(301,933,609)</b>	<b>(221,141,776)</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimët afatgjatë</b>			
Huatë - pjesa afatgjatë	15	495,544,500	416,790,005
Provizionet	16	576,509	572,488
		<b>496,121,009</b>	<b>417,362,493</b>
<b>Detyrimët afatshkurtra</b>			
Huatë - pjesa afatshkurtër	15	21,768,734	20,846,825
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	17	992,985,472	754,885,345
Tarifa e koncesionit	18	16,586,168	-
Detyrime të tjera	19	17,780,397	5,479,930
		<b>1,049,120,771</b>	<b>781,212,100</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>1,545,241,780</b>	<b>1,198,574,593</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>1,243,308,171</b>	<b>6,800,000</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 25 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.****Pasqyra gjithpërfshirëse e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Të ardhura operative	20	860,356,830	-
Kosto e mallrave të shitur	21	(411,103,861)	-
<b>Fitimi bruto</b>		<b>449,252,969</b>	<b>-</b>
Furnizime dhe shërbime	22	(109,612,602)	(132,120,279)
Shpenzime për personelin	23	(133,839,614)	(55,010,502)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	6	(146,949,779)	(3,873,089)
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	7	(45,565)	(18,985)
Rënia në vlerë e inventarit	24	(6,805,138)	-
Nxjerrje jashtë përdorimit të inventarit	25	(8,371,530)	-
Honorare për të drejtat e autorit	26	(43,707,641)	-
Tarifa e koncesionit	18	(16,586,168)	-
(Humbje) / fitime të tjera neto	27	(10,778,961)	23,556,997
		<b>(476,696,998)</b>	<b>(167,465,858)</b>
<b>Humbjet operative</b>		<b>(27,444,029)</b>	<b>(167,465,858)</b>
Të ardhura financiare	28	19,071	96,405
Shpenzime financiare	28	(45,526,363)	(21,292,251)
<b>Shpenzime financiare neto</b>		<b>(45,507,292)</b>	<b>(21,195,846)</b>
<b>Humbja para tatimit</b>		<b>(72,951,321)</b>	<b>(188,661,704)</b>
(Shpenzimi)/ e ardhura e tatimit mbi fitimin	29	(7,840,514)	22,415,065
		<b>(7,840,514)</b>	<b>-</b>
<b>Humbja për vitin</b>		<b>(80,791,835)</b>	<b>(166,246,639)</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse pas tatim-fitimit		-	-
<b>Humbja gjithpërfshirëse e vitit</b>		<b>(80,791,835)</b>	<b>(166,246,639)</b>

Pasqyra gjithpërfshirëse e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 25 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.**  
**Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
<b>Flukse monetare nga veprimtaritë operative:</b>			
Humbja para tatimit		(72,951,321)	(188,661,704)
<i>Rregullime:</i>			
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	6	146,949,779	3,873,089
Riklasifikimi i AAM në shpenzime	6	488,977	-
Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale	7	45,565	18,985
Rënie në vlerë e inventarëve	24	6,805,138	-
Dalje jashtë përdorimit e inventarëve	25	8,371,530	-
Humbje/(fitime) nga rivlerësimi i huave		2,142,708	(12,153,953)
Efekti i skontimit të provizionit	16	4,021	7,959
Shpenzime për interesin	28	42,431,407	20,846,825
Të ardhura nga interesi	28	(19,071)	(96,405)
Fitime/(humbje) operative para ndryshimeve në kapitalin qarkullues		<b>134,268,733</b>	<b>(176,165,204)</b>
Pakësime/ (rritje) në inventar		1,141,525	(192,867,419)
Rritje në parapagime dhe të tjera të arkëtueshme		(3,395,522)	(168,618,660)
Rritje në llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme		238,100,127	692,771,815
Rritje në detyrimin e tarifës së koncesionit	18	16,586,168	-
Rritje në detyrime të tjera		12,300,467	5,460,859
<b>Flukse monetare nga veprimtaritë operative</b>		<b>399,001,498</b>	<b>160,581,391</b>
Interesa të paguara		(41,462,713)	-
Tatimi mbi fitimin i paguar	11	(600,000)	(171,250)
<b>Mjete monetare gjeneruar nga veprimtaritë operative</b>		<b>356,938,785</b>	<b>160,410,141</b>
<b>Flukse monetare nga veprimtaritë investuese:</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	6	(422,116,214)	(584,963,920)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	7	-	(182,260)
Interesi i arkëtuar	28	19,071	96,405
<b>Mjetet monetare neto përdorur në veprimtaritë investuese</b>		<b>(422,097,143)</b>	<b>(585,049,775)</b>
<b>Flukse monetare nga veprimtaritë financuese:</b>			
Paguar kapitali nga aksionerët		-	6,800,000
Arkëtime nga huamarrje		76,565,000	429,381,425
<b>Mjete monetare neto gjeneruar nga veprimtaritë financuese</b>		<b>76,565,000</b>	<b>436,181,425</b>
<b>Rritja neto e mjeteve monetare</b>		<b>11,406,642</b>	<b>11,541,791</b>
<b>Mjetet monetare dhe të tjera ekuivalente në fillim të vitit</b>	12	<b>11,541,791</b>	-
<b>Mjetet monetare dhe të tjera ekuivalente në fund të vitit</b>	12	<b>22,948,433</b>	<b>11,541,791</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 25 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.


**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.****Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

	Kapitali i nënshkruar i paguar	Kapitali i nënshkruar i papaguar	Humbjet e akumuluar	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2011</b>	-	<b>6,800,000</b>	<b>(61,695,135)</b>	<b>(54,895,135)</b>
Pagesa e kapitalit të nënshkruar	6,800,000	(6,800,000)	-	-
Humbja për vitin	-	-	(166,246,639)	(166,246,639)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2011</b>	<b>6,800,000</b>	-	<b>(227,941,774)</b>	<b>(221,141,774)</b>
Humbja për vitin	-	-	(80,791,835)	(80,791,835)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2012</b>	<b>6,800,000</b>	-	<b>(308,733,609)</b>	<b>(301,933,609)</b>

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Bordi i Drejtorëve të SICPA Security Solutions Albania Sh.p.k më datë 29 mars 2013 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

  
Xavier Davard  
Administrator



  
Juliana Mali  
Manaxhere Finance

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 25 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## **1 Informacion i përgjithshëm mbi Shoqërinë**

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k. ("SICPA" ose "Shoqëria") është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve (QKR) më 20 shtator 2010 me NIPT L02120032R.

Veprimtaria e Shoqërisë do të konsistojë në implementimin e Marrëveshjes së Koncesionit për Shërbim ('Marrëveshja e Koncesionit') të lidhur midis Ministrisë të Financave të Republikës së Shqipërisë ('Autoriteti') për printimin, prodhimin dhe furnizimin e pullave fiskale si dhe veprimtari të tjera në zbatim të Marrëveshjes së Koncesionit si krijimi dhe mirëmbajtja e një Godine Prodhimi Qendrore në ambientet që do të caktohen nga Autoriteti; projektimin, zhvillimin, financimin, testimin, vënien në punë dhe mirëmbajtjen e sistemit, Sistemin Qendror të Gjurmimit dhe Monitorimit dhe Njësitë Kompjuterike gjatë periudhës së marrëveshjes. Koncesioni është dhënë për një afat prej 10 vitesh duke filluar që nga data në të cilën kontrata hyn në fuqi ('Data efektive').

Marrëveshja e Koncesionit nuk ishte ende efektive më 31 dhjetor 2012. Ajo u bë tërësisht efektive më 6 shkurt 2013.

SICPA Security Solutions Albania sh.p.k zotërohet nga SICPA Security Solutions SA me vendndodhje në Zvicër.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2012 është 6,800,000 Lek.

Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë është Z. Xavier Davard.

Selia e regjistruar e Shoqërisë është në "Autostrada Tiranë – Durrës, km 4, Kashar, Tiranë.

Numri i punëtorëve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2012 ishte 41 (2011: 35).

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga bordi i drejtorëve të SICPA Security Solutions Albania sh.p.k. më 29 mars 2013 dhe u nënshkruan në emër të tyre nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Xavier Davard dhe Drejtoresha e Financës Zj. Juliana Mali.

## **2 Mjedisi operativ i Shoqërisë**

Shqipëria shfaq tipare të një tregu në rritje me një inflacion të qëndrueshëm. Vendi ka përjetuar një rritje të qëndrueshme ekonomike në vitet e fundit.

### *Paqëndrueshmëria e kohëve të fundit në tregjet financiare botërore dhe atë shqiptar*

Kriza botërore financiare e vazhdueshme që erdhi si rezultat i reduktimit në masë të likuiditetit botëror që filloi në mes të vitit 2007 (që shpesh përmendet si "Credit Crunch") ka rezultuar, mes të tjerash, në nivele likuiditeti të ulëta të sektorit bankar dhe ekonomisë në përgjithësi, interesi më të larta huaje dhe politika huadhënëse më konservatore. Impakti i krizës financiare u bë më i dukshëm në Shqipëri gjatë vitit 2009 kur u regjistrua një rënie e përgjithshme e aktivitetit ekonomik bashkë me një zhvlerësim të vazhdueshëm të monedhës lokale. Gjatë vitit 2012 Shqipëria përjetoi një rritje ekonomike dhe pse kjo ishte rritja më e ulët përgjatë viteve të fundit dhe kursi i kembimi LEK-EUR e LEK-USD ka qënë i pandryshueshëm.

### *Impakti në likuiditetin e Shoqërisë*

Mundësia e financimit të huaj në tregun financiar mund të ulet në vitin që vjen. Kjo mund të përbëjë problem për Shoqërinë pasi likuiditeti i saj varet në mënyrë të konsiderueshme nga fluksi monetar i ardhur nga shitjet e Pullave Fiskale të cilat nga ana e tyre varen nga detyrimi financiar dhe vullneti i prodhuesve të mallrave për Shqipërinë që t'i afrohen Shoqërisë me kërkesa për Pulla Fiskale për produktet e tyre.

### *Impakti mbi klientët dhe huamarrësit*

Prodhuesit e mallrave që klasifikohen nga legjislacioni shqiptar si produkte të cilat duhet të pajisen me Pulla Fiskale janë klientët e vetëm të Shoqërisë të cilët mund të ndikohen negativisht nga kriza financiare e vazhdueshme dhe kjo mund të çojë në vështirësi për të paguar.

Për Drejtimin është e pamundur të përcaktojë në mënyrë të saktë efektet mbi gjendjen financiare të ardhshme të Shoqërisë lidhur me ndonjë përqësimit të mundshëm të mjedisit operativ të Shoqërisë si pasojë e krizës aktuale. Drejtimi beson se po merr të gjitha masat e nevojshme për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e biznesit të Shoqërisë në rrethanat aktuale.

Megjithatë, pavarësisht komenteve të mësipërme, drejtimi beson se impakti i krizës botërore financiare mbi gjendjen financiare të Shoqërisë do të jetë i papërfillshëm në vitin që pason.

### **3 Përmbledhje e politikave kontabël**

Politikat kryesore kontabël që janë përdorur në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare paraqiten si më poshtë. Këto politika kontabël janë aplikuar në mënyrë konsistente përvec nëse specifikohet ndryshe.

#### **3.1 Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike.

Drejtimi i ka përgatitur këto pasqyra financiare në bazë të parimit të vijimësisë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e disa vlerësimeve të rëndësishme kontabël dhe kërkon gjithashtu që drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij gjatë zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Çështjet që kërkojnë një shkallë të lartë gjykimi, që kanë një shkallë të lartë kompleksiteti, apo ato për të cilat supozimet dhe vlerësimet kanë ndikim të rëndësishëm për pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin shpjegues 5.

Standardet e mëposhtme dhe ndryshimet apo interpretimet e standardeve ekzistuese janë të detyrueshme për periudhat kontabël të Shoqërisë që fillojnë më ose pas datës në të cilën ato hyjnë në fuqi:

#### **(a) Standarde të reja, të ndryshuara dhe interpretime që kërkojnë zbatim për vitin financiar që fillon më apo pas 1 janarit 2012 dhe relevante për aktivitetin e Shoqërisë**

Nuk ka standarde të reja, të ndryshuara apo interpretime të reja të cilat hyjnë në fuqi për herë të parë më ose pas datës 1 janar 2012 dhe që kanë një ndikim të rëndësishëm ndaj Shoqërisë.

#### **(b) Standarde të reja, të ndryshuara dhe interpretime që kërkojnë zbatim për herë të parë për vitin financiar që fillon më apo pas 1 janarit 2012 por të parëndësishme aktualisht për Shoqërinë**

Ndryshimi i mëposhtëm për një standard ekzistues është i detyrueshëm për vitin financiar që fillon më apo pas 1 janarit 2012, por që nuk është relevant për aktivitetin e Shoqërisë:

Ndryshimet në SNK 1, "Paraqitja e pasqyrave financiare" (publikuar në qershor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2012) ndryshojnë mënyrën e paraqitjes e shënimeve shpjeguese të zërave të përfshira në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Ndryshimet kërkojnë që njësia ekonomike të paraqesë zërat e paraqitur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në dy grupe, në varësi të faktit nëse ekziston mundësia e ri-klasifikimit të tyre në fitim ose humbje në të ardhmen. Emërtimi i sugjeruar nga SNK 1 është ndryshuar në "pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse". Ndryshimet nuk janë relevante për pasqyrat financiare të Shoqërisë meqenëse Shoqëria nuk ka të ardhura gjithëpërfshirëse të tjera.

#### **(c) Standarde të reja, të ndryshuara dhe interpretime që nuk janë ende në fuqi dhe që Shoqëria nuk i ka adoptuar më herët**

Standardet e reja, të ndryshuara dhe interpretimet që paraqiten më poshtë janë të detyrueshme për vitet financiare që fillojnë më apo pas datës efektive, por që Shoqëria nuk i ka adoptuar më herët:

SNRF 9, "Instrumentet financiare: klasifikimi dhe matja". Ky standard, i publikuar në nëntor të vitit 2009, zëvendëson ato pjesë të SNK 39 që lidhen me klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. SNRF 9 u ndryshua më tej në tetor 2010 për të përcaktuar klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare dhe në dhjetor 2011 (i) për të ndryshuar datën efektive në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2015 dhe (ii) për të përfshirë shënime shpjeguese për periudhën kalimtare. Karakteristikat kryesore të standardit janë si më poshtë:

- Aktiviteti financiar duhet të klasifikohet në dy kategori matje: në aktive financiare të cilat do të maten në periudhat e mëpasshme me vlerë të drejtë, dhe ato të cilat do të maten në periudhat e mëpasshme me kosto të amortizuar. Vendimi duhet të merret në momentin e njohjes fillestare të aktivitetit. Klasifikimi varet nga modeli që njësia ekonomike ndjek për menaxhimin e aktiveve të veta financiare dhe karakteristikat e flukseve monetare të instrumentit.
- Një instrument matet në periudhat e mëpasshme me kosto të amortizuar vetëm nëse është një instrument borxhi dhe dy kushtet në vijim plotësohen njëkohësisht: (i) objektivi i njësies ekonomike është të mbajë aktivin për të mbledhur/përfitur flukset monetare kontraktuale, dhe (ii) flukset monetare kontraktuale të aktivitetit përfaqësojnë vetëm pagesa principali dhe interesi (që do të thotë që instrumenti ka vetëm "karakteristikat bazë të huasë"). Të gjithë instrumentet e tjerë të borxhit duhet të maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- Të gjithë instrumentet e kapitalit duhet të vlerësohen në periudhat e mëpasshme me vlerë të drejtë. Instrumentet e kapitalit të cilat mbahen për tregtim do të maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Ndërkohë, për gjithë instrumentet e tjerë të kapitalit, në momentin e njohjes fillestare mund të bëhet

një zgjedhje e pakthyeshme për të njohur fitimet dhe humbjet kapitale të realizuara dhe të perealizuara përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe jo përmes fitimit ose humbjes. Fitimet ose humbjet nga vlera e drejtë nuk do të kalojnë më përmes fitimit ose humbjes. Kjo zgjedhje mund të bëhet veçmas për çdo instrument. Dividendët duhet të prezantohen në fitim ose humbje, për sa kohë që përfaqësojnë kthime nga investimi.

- Pjesa më e madhe e kërkesave të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë transferuar pa ndryshime tek SNRF 9. Ndryshimi kryesor është se njësisë ekonomike tashmë i kërkohet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun kreditor të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes në të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

SNRF 13, "Matja e vlerës së drejtë" (publikuar në maj të vitit 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013), ka për qëllim të përmirësojë konsistencën dhe të reduktojë kompleksitetin duke ofruar një përkufizim të rishikuar të vlerës së drejtë, një burim të vetëm për matjen e vlerës së drejtë, si dhe kërkesat për dhënien e shënimeve shpjeguese për përdorim nga gjithë SNRF-të.

SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale" (publikuar në maj 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013), është ndryshuar dhe objekti i tij tashmë është të përshkruajë kontabilizimin dhe kërkesat për shënime shpjeguese për investimet në filiale, në njësi ekonomike të kontrolluara bashkarisht dhe në sipërmarrje, për një njësi ekonomike që përgatit pasqyra financiare individuale. Udhëzuesi mbi kontrollin dhe pasqyrat financiare të konsoliduara është zëvendësuar nga SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara".

Ndryshimi në SNK 19, "Përfitimet e punonjësve" (publikuar në qershor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013) sjell ndryshime të rëndësishme në njohjen dhe matjen e shpenzimeve të pensionit të përfituara dhe përfitimeve nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës si dhe në shënimet shpjeguese për të gjithë përfitimet e punonjësve. Standardi kërkon njohjen e të gjitha ndryshimeve në detyrimin (aktivin) neto të lidhur me këto përfitime atëherë kur ato ndodhin, si: (i) kosto shërbimit dhe interesa neto në fitim apo humbje; dhe (ii) ri-matje në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Ndryshime në SNRF 7, "Shënimet shpjeguese – Kompensimi i aktiveve dhe pasiveve financiare" (publikuar në dhjetor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2013). Ndryshimet kërkojnë dhënie të shënimeve shpjeguese në pasqyrat financiare të cilat mundësojnë vlerësim të efektit apo efektin e mundshëm të marrëveshjeve të kompensimit nga lexuesi i pasqyrave, duke përfshirë edhe të drejtat për kompensim.

Ndryshime në SNK 32, "Kompensimi i aktiveve dhe pasiveve financiare" (publikuar në dhjetor 2011 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose më pas datës 1 janar 2014). Ndryshimet kanë sjellë udhëzime shtesë për zbatimin e SNK 32 për të mënjeluar mungesën e konsistencës lidhur me zbatimin e disa prej kritereve të kompensimit, duke përfshirë sqarimin e kuptimit të shprehjes "e drejtë ligjore e detyrueshme për të kompensuar" dhe disa sisteme të kompensimit në baza bruto që mund të konsiderohen ekuivalente me ato të kompensimit neto.

Përmirësime të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (publikuar në maj 2012 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2013). Përmirësimet konsistojnë në ndryshime të pesë standardeve.

- SNRF 1 u ndryshua (i) për të qartësuar se një njësi ekonomike që rinis të përgatisë pasqyrat e saj financiare SNRF mund të ri-aplikojë SNRF 1 ose të aplikojë të gjitha SNRF-të retrospektivisht sikur të mos kishte ndaluar ndonjëherë së aplikuar ato, dhe (ii) për të shtuar një përjashtim nga aplikimi retrospektiv i SNK 23 "Kosto të huamarrjes" nga zbatuesit për herë të parë të SNRF-ve.
- SNK1 u ndryshua për të qartësuar se shënimet shpjeguese nuk nevojiten për të mbështetur pasqyrën e paraqitur për periudhën e tretë krahasuese e cila kërkohet të ri-paraqitet për shkak retrospektivitet ndikimit të rëndësishëm të ri-paraqitjes retrospektive, ndryshime në politikat kontabël apo ri-klasifikime për qëllime të paraqitjes, ndërkohë që dhënia e shënimeve shpjeguese do të jetë e nevojshme vetëm nëse shoqëria vendos që të ofrojë pasqyra krahasuese shtesë vullnetarisht.
- SNK 16 u ndryshua për të qartësuar se pajisjet e shërbimit të cilat do të përdoren për më shumë se një periudhe do të klasifikohen si aktive afatgjata materiale dhe jo si inventar.
- SNK 32 u ndryshua për të qartësuar se pasojat fiskale të shpërndarjeve ndaj aksionarëve duhet të kontabilizohen në pasqyrën e të ardhurave, siç janë kërkuar gjithmonë nga SNK 12. SNK 34 u ndryshua për të mundësuar përputhjen e kërkesave të saj me ato të SNRF 8.
- SNK 34 do të kërkojë dhënien e shënimeve shpjeguese për një tregues të matjes së totalit të aktiveve dhe pasiveve për një segment operativ të caktuar, vetëm nëse ky informacion i jepet rregullisht vendimmarrësit të aktivitetit operativ dhe ka patur një ndryshim të rëndësishëm në këto tregues nga pasqyrat financiare të vitit të kaluar.

Standarde dhe interpretime të tjera të rishikuara të cilat nuk janë të rëndësishme për Shoqërinë:

SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara"

SNRF 11, "Marrëveshjet e përbashkëta"

SNRF 12, "Shënimet shpjeguese mbi interesat në njësi të tjera ekonomike"

SNK 28, "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"

SNRF 1 "Zbatimi i SNFR-ve për herë të parë – Huatë qeveritare"

SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27 – "Njësitet ekonomike investuese"

KIRFN 20, "Shpenzimet e heqjes në procesin e prodhimit të një sipërfaqeje minerare"

Standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë, nëse më sipër nuk është përmendur ndryshe.

### **3.2 Transaksionet në monedhë të huaj**

#### ***Monedha funksionale dhe e paraqitjes***

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare të Shoqërisë janë matur me monedhën e mjedisit ekonomik në të cilin operon Shoqëria ('monedha funksionale'). Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ('Lek'), që është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### ***Transaksionet dhe gjendjet***

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve ose të rivlerësimeve në rastin e zërave që rivlerësohen. Fitimet dhe humbjet nga ndryshimi i kursit të këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga konvertimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit njihen në fitime ose humbje.

Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit paraqiten në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave në zërin 'Fitime të tjera neto'.

### **3.3 Aktive afatgjata materiale**

#### ***a) Njohja dhe matja***

Aktivet afatgjata materiale ('AAM') paraqiten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin e akumuluar (nëse ka).

Kostoja përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nëse ka), kosto të tjera që i atribuohen drejtpërdrejt sjelljes së aktivitetit në gjendje pune për një qëllim të caktuar dhe koston e çmontimit si dhe të heqjes së pajisjeve dhe rikthimin në gjendje normale të vendit ku ishte ngritur aktivi. Shpenzimet kapitale për aktivet gjatë ndërtimit mbarten në zërin "Aktive në progres" dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktiveve pasi është përfunduar ndërtimi.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale. "Pjesë këmbimi e pajisje kryesore rezervë" janë klasifikuar si aktive afatgjata materiale në vitin 2011 meqenëse pritej që t'i nënshtroheshin proceseve të mëtejshme të instalimit gjatë vitit 2012 së bashku me zëra të tjerë të klasifikuar si "Aktive në proces", në mënyrë që të ishin më në fund të gatshme për përdorim dhe të transferoheshin te zëri 'Makinëri e pajisje teknike'. Në bazë të Marrëveshjes së Koncesionit një pjesë e këtyre aktiveve mbeten në pronësi të Shoqërisë por u jepen në përdorim pa pagesë dhe instalohen pranë ambienteve të klientëve të cilët i përdorin për prodhimin e Pullave Fiskale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël të aktiveve afatgjata materiale dhe njihen si neto në zërin "të ardhura të tjera" në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### ***b) Kostot e mëpasshme***

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të zërit nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese dhe kosto e pjesës mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të zakonshme ndaj aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

**c) Amortizimi**

Amortizimi ngarkohet në fitim ose humbje në bazë të metodës lineare, përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale nga momenti kur është i gatshëm për përdorim. Përmirësimet e ambienteve të marra me qira amortizohen mbi bazën e afatit më të shkurtër kohor të periudhës së marrjes me qira dhe jetëgjatësisë së tyre.

Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe krahasuese janë si më poshtë:

Përmirësimet e kryera në ambientet me qira	Afati i qirasë
Instalime	20%
Pajisje zyre	20%
Kompjutera dhe pajisje IT	25%
Makineri e pajisje teknike	20%

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

**3.4 Aktive afatgjata jo-materiale***Programe kompjuterike*

Licencat e fituara të programeve kompjuterike janë kapitalizuar në bazë të shpenzimeve të bëra për të blerë dhe për të vënë në përdorim programe të veçanta. Këto shpenzime janë amortizuar në bazë të metodës lineare me një normë vjetore prej 25%.

**3.5 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare**

Vlerat kontabël të aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve tatimore të shtyra, rishikohen për zhvlerësim sa herë që ka ngjarje ose ndryshime në rrethana të cilat tregojnë se vlera e mbartur e tyre nuk mund të jetë e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet për vlerën me të cilën vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë të një aktivi pas zbritjes së shpenzimeve të shitjes dhe vlerës në përdorim të tij. Për qëllime të përcaktimit të zhvlerësimit, aktivet grupohen në grupet më të vogla të mundshme për të cilat flukst monetare identifikohen lehtësisht (njësi gjeneruese të mjeteve monetare).

**3.6 Instrumente financiare**

Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo-derivate, duke përfshirë llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera, mjete monetare dhe ekuivalente me to, kredi dhe hua, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera.

Instrumentet financiare jo-derivate njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentet jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, çdo kosto direkte që u atribuohen transaksioneve, përveç siç është përshkruar më poshtë. Pas njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivate maten siç është përshkruar më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen nëse skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë për flukset monetare nga aktivet financiare ose nëse Shoqëria transferon aktivet financiare tek një palë tjetër, pa mbajtur kontroll mbi to, ose transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e aktivitetit. Blerjet normale dhe shitjet e aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet për të blerë ose shitur aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuar në kontratë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

*Mjete monetare dhe ekuivalente me to*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë para në arkë, depozita pa afat të mbajtura në bankë, investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturim origjinal prej tre muajsh ose më pak. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë e më pas me kosto të amortizuara.

*Llogaritë e arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me kosto të amortizuara duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

*Llogari të pagueshme dhe të tjera*

Llogaritë e pagueshme paraqiten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuara.

#### *Huadhëniet dhe huamarrjet*

Huadhëniet dhe huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë. Pas njohjes fillestare, huadhëniet dhe huamarrjet paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në fitime ose humbje çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

#### *Tarifa e koncesionit*

Shoqëria detyrohet t'i paguajë Autoritetit për të drejtat dhe privilegjet e akorduara me Marrëveshjen e Koncesionit një tarifë koncesioni prej 2% mbi të ardhurat vjetore neto nga shitja e Pullave Fiskale, bazuar në pasqyrat financiare të audituara të Shoqërisë për çdo vit financiar. Tarifat e koncesionit të pagueshme ndaj Autoritetit regjistrohen si detyrime financiare në momentin e njohjes së të ardhurave neto nga shitja e Pullave Fiskale. Ato maten me vlerën e drejtë të pagueshme ndaj Autoritetit.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Instrumentet financiarë klasifikohen si detyrime afatshkurtra me përjashtim të rastit kur Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar të shtyjë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së raportimit.

### **3.7 Zhvlerësimi i aktiveve financiare**

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parashikuara të aktivit.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën fillestare efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera të mbetura financiare vlerësohen kolektivisht, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitime ose humbje.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në fitime ose humbje.

### **3.8 Inventarët**

Inventarët paraqiten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto përcaktohet duke përdorur metodën e kostos standarde dhe përbëhet nga kostot e materialeve direkte, punës direkte, kosto të tjera direkte dhe shpenzime të lidhura me prodhimin. Shoqëria kryen në mënyrë periodike analiza për krahasimin e kostos aktuale me atë standarde dhe diferencat që rezultojnë nga këto analiza i regjistron si "Kosto e mallrave të shitur". Vlera neto e realizueshme është çmimi fiks i shitjes për njësi sic është përcaktuar në Marrëveshjen e Koncesionit, duke zbritur shpenzimet variabël të shitjes.

### **3.9 Aktive afatgjata të mbajtura për shitje**

Aktive afatgjata dhe grupe që mbahen për t'u shitur (që mund të përmbajnë aktive afatgjata dhe afatshkurtra) klasifikohen në pasqyrën e pozicionit financiar si "Aktive afatgjata të mbajtura për shitje" nëse vlera e tyre kontabël do të rimerret parimisht nëpërmjet një transaksioni shitjeje (duke përfshirë dhe humbjen e kontrollit të një filiali që mban aktivin) brenda 12 muajve pas periudhës së raportimit. Aktivet klasifikohen si të tilla kur të gjitha kushtet e mëposhtme plotësohen: (a) aktivet janë të përshtatshme për shitje të menjëhershme në kushtet e tyre aktuale; (b) drejtimi i Shoqërisë ka aprovuar dhe filluar një program aktiv për gjetjen e një blerësi; (c) aktivet janë lehtësisht të tregtueshme për një çmim të arsyeshëm; (d) shitja pritet të ndodhë brenda një viti; dhe (e) është shumë pak e mundur që do të bëhen ndryshime thelbësore në planin e shitjes ose që plani do të tërhiqet.

Aktive afatgjata ose grupe që mund të shiten që klasifikohen si të mbajtura për shitje në pasqyrat financiare të periudhës aktuale nuk riklasifikohen apo riprezantohen në pasqyrën krahasuese të pozicionit financiar për të reflektuar klasifikimin në fund të periudhës aktuale.

### **3.10 Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

### **3.11 Tatimi mbi fitimin dhe tatimi i shtyrë**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet drejtpërdrejt në fitime ose humbje përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi mbi të ardhurat e periudhës llogaritet në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi në datën e raportimit. Periodikisht nga drejtimi bëhen vlerësime të pozicionit të detyrimeve tatimore sipas formularëve të deklarimit në përputhje me interpretimet dhe rregullat tatimore. Drejtimi vendos mbi provizionet për t'u krijuar mbi bazën e shumave të pritshme për t'u paguar ndaj autoriteteve tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi deri në datën e raportimit.

Një tatim i shtyrë aktiv njihet deri në atë masë ku mund të pritet që në të ardhmen të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme për realizimin e diferencave të përkohshme.

Aktivet nga tatimet e shtyra rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në rastet kur nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe atij të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e një pozicioni tatimor të paqartë dhe gjithashtu mundësinë e rritjes së detyrimit tatimor dhe interesave. Shoqëria beson se njohja e detyrimeve fiskale është e përshtatshme për vitet në vazhdim pasi është bazuar në vlerësimin e një sërë faktorësh, përfshirë interpretimin e ligjit tatimor si dhe eksperiencave të mëparshme.

Ky vlerësim mbështetet në një sërë vlerësimesh dhe supozimesh që përfshijnë gjykime lidhur me ngjarje të ardhshme. Informacione të reja mund të shkaktojnë ndryshime në gjykimin e Shoqërisë lidhur me përshtatshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; të tilla ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore të periudhës së caktuar.

### **3.12 Përfitimet e punonjësve**

*Kontributi për sigurime shoqërore, shëndetësore dhe pension*

Shoqërisë i kërkohet nga legjislacioni aktual shqiptar që të derdhë kontribute të caktuara në lidhje me të punësuarit në një fond social që operohet nga shteti. Të gjithë pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzim në periudhën së cilës i përkasin.

### **3.13 Provizionet**

Provizionet për restaurimin e infrastrukturës, kostot e rikonstruksionit, si dhe ankimime ligjore njihen kur Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, kur ekziston mundësia e flukseve dalëse të burimeve ekonomike për të shlyer detyrimet, dhe kur vlera e detyrimit mund të përcaktohet më vertetësi. Provizionet nuk njihen për humbjet e ardhshme operative.

Kur ka një numër detyrimesh të ngjashme, gjasat që një fluks dalës do të kërkohet për shlyerje përcaktohet duke marrë në konsideratë klasën e detyrimeve në tërësi. Një provizion njihet edhe nëse gjasat për një fluks dalës në lidhje më cdo zë të përfshirë në të njëjtën klasë detyrimesh mund të jenë të vogla.

Provizionet maten me vlerën aktuale të skontuar të shpenzimeve të pritshme për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë skontimi para tatimit e cila pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Rritja në provizione si pasojë e kalimit të kohës njihet si shpenzime për interesa.

### **3.14 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat janë flukset bruto nga përfitimet ekonomike gjatë periudhës që vijnë si rrjedhim i aktiviteteve normale të subjektit kur këto flukse rezultojnë në rritje të kapitalit, të ndryshme nga rritjet të cilat vijnë si rrjedhojë e kontributit nga aksionerët. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të pagesave të marra ose të arkëtueshme për shitjen e mallrave/shërbimeve gjatë aktivitetit normal të Shoqërisë. Të ardhurat paraqiten neto nga TVSH-ja, kthimet, uljet për nivele shitjesh, zbritjet dhe pasi eliminohen shitjet brenda Shoqërisë, nëse ka. Për aktivitete tregtare normale të Shoqërisë, të ardhurat nga shitja njihen në datën e lëvrimit të produktit final drejt klientit.

Shoqëria i njehtë ardhurat kur vlera e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme, kur është e mundur që Shoqëria do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, dhe kur përmbushen kritere të caktuara. Vlera e të ardhurave nuk konsiderohet si e vlerësuar besueshëm deri në momentin kur të gjitha pasiguritë në lidhje me shitjen të jenë zgjidhur.

*Të ardhurat nga interesi*

Të ardhura nga interesat njihen mbi baza kohore duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kur një kërkesë e arkëtueshme zhvlerësohet, Shoqëria zvogëlon vlerën kontabël të saj deri në vlerën e rikuperueshme, e cila është e barabartë me vlerën e skontuar të flukseve monetare të ardhshme me normën e interesit efektiv të instrumentit, dhe vazhdon me njohjen e skontimit si të ardhura nga interesi.

*Të ardhura të tjera*

Të ardhura të tjera përfshijnë të ardhura nga aktiviteti i zakonshëm i Shoqërisë (fitime nga shitjet e aktiveve, pagesa nga sigurimet për dëmtimet e pësuar, etj.) të cilat njihen në periudhën në të cilën ato ndodhin.

**3.15 Qiratë**

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra për qiratë operative (neto nga stimuj që vijnë prej qiradhënësit) janë ngarkuar në fitim ose humbje mbi bazën e metodës lineare përgjatë periudhës së kohëzgjatjes së qirasë.

**4 Menaxhimi i riskut financiar**

**4.1 Faktorët e riskut financiar**

Aktivitetet e Shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare: risku i tregut (duke përfshirë riskun valutor, riskun e normës së interesit, dhe riskun e çmimeve), risku i kreditit dhe risku i likuiditetit. Programi i përgjithshëm i Shoqërisë i menaxhimit të riskut fokusohet në vendosjen e kufijve të ekspozimeve ndaj risqeve të ndryshme.

*Risku i tregut*

Risku i tregut është risku i humbjes që rezulton nga ndryshimet në çmime, nga normat e këmbimit valutor, nga normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Niveli i riskut të tregut ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar në një moment të dhënë kohe ndryshon në varësi të kushteve të tregut, të ligjeve dhe rregulloreve të nxjerra nga Autoriteti si dhe të pritshmërive të monedhës në të ardhmen ose të lëvizjeve të normave të interesit të tregut.

Menaxhimi vendos limite për vlerën e riskut që mund të pranohet, nivel që monitorohet çdo muaj. Megjithatë, përdorimi i kësaj metode nuk i parandalon humbjet jashtë këtyre kufijve në momentet e lëvizjeve të mëdha në treg.

**(i) Risku i kursit të këmbimit**

Shoqëria operon dhe është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit që rrjedh nga ekspozimet e monedhës, kryesisht në lidhje me Euron, Frangën Zvicerane ("CHF") dhe Dollarit Amerikan.

Risku i kursit të këmbimit lind kur transaksionet e ardhshme tregtare ose aktive dhe detyrime të njohura janë në një monedhë që nuk është monedha funksionale e subjektit.

Në lidhje me riskun e monedhës, menaxhimi vendos kufizime mbi nivelin e ekspozimit ndaj cdo monedhe dhe në total. Pozicionet monitorohen çdo muaj.

Shoqëria nuk ka hyrë në transaksione mbrojtëse për ekspozimin ndaj rrezikut valutor pasi nuk pret humbje të rëndësishme për shkak të alternativave në normat e monedhës krahasuar me atë që është dominante deri në datën e raportimit.

Kurset e rëndësishme të këmbimit të shprehura ne Lek për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit janë paraqitur më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>31 dhjetor 2011</b>
EUR	139.59	138.93
CHF	115.65	114.46



**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2012 dhe 31 dhjetor 2011 ishte si më poshtë:

31 dhjetor 2012	Ekuivalentët në Lek			
	LEK	EUR	CHF	Total
<b>Aktive financiare</b>				
Llogari të arkëtueshme (shënimi 10)	-	1,056,608	-	1,056,608
Të arkëtueshme nga personeli (shënimi 10)	328,275	451,644	-	779,919
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente (shënimi 12)	728,258	22,220,175	-	22,948,433
	<b>1,056,533</b>	<b>23,728,427</b>	-	<b>24,784,960</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Huamarrje (shënimi 15)	-	(517,313,234)	-	(517,313,234)
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme (shënimi 17)	(877,578)	(979,579,824)	(12,528,070)	(992,985,472)
Tarifa e pagueshme e koncensionit (shënimi 18)	(16,586,168)	-	-	(16,586,168)
	<b>(17,463,746)</b>	<b>(1,496,893,058)</b>	<b>(12,528,070)</b>	<b>(1,526,884,874)</b>
<b>Risku i kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2012</b>	<b>(16,407,213)</b>	<b>(1,473,164,631)</b>	<b>(12,528,070)</b>	<b>(1,502,099,914)</b>

31 dhjetor 2011	Ekuivalentët në Lek			
	LEK	EUR	CHF	Total
<b>Aktive financiare</b>				
Të arkëtueshme nga personeli (shënimi 10)	948,282	-	-	948,282
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente (shënimi 12)	5,959,881	5,581,910	-	11,541,791
	<b>6,908,163</b>	<b>5,581,910</b>	-	<b>12,490,073</b>
<b>Detyrime financiare</b>				
Huamarrje (shënimi 15)	-	(437,636,830)	-	(437,636,830)
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme (shënimi 17)	(1,309,129)	(745,749,785)	(7,826,431)	(754,885,345)
Të pagueshme personelit (shënimi 19)	(307,514)	-	-	(307,514)
	<b>(1,616,643)</b>	<b>(1,183,386,615)</b>	<b>(7,826,431)</b>	<b>(1,192,829,689)</b>
<b>Risku i kurseve të këmbimit më 31 Dhjetor 2011</b>	<b>5,291,520</b>	<b>(1,177,804,705)</b>	<b>(7,826,431)</b>	<b>(1,180,339,616)</b>

Forcimi ose dobësimi i monedhës Lek me 10% kundrejt monedhës Euro më 31 dhjetor 2012 do të sillte rritje ose ulje në fitime ose humbje në shumën 147,316,463 Lek (2011: rritje ose ulje në shumën 117,780,471 Lek).

Forcimi ose dobësimi i monedhës Lek me 10% kundrejt monedhës CHF më 31 dhjetor 2012 do të sillte rritje ose ulje në fitime ose humbje në shumën 1,252,807 Lek (2011: 782,643 Lek).

**(ii) Risku i çmimit**

Shoqëria nuk ka asnjë ekspozim ndaj riskut të çmimeve të kapitalit, pasi nuk mban aktive financiare që përfshijnë instrumente kapitali në datën e raportimit. Nuk është politika e Shoqërisë të blejë instrumente të tilla duke ekspozuar veten ndaj rreziqeve të çmimeve që lidhen me lëvizjet në treguesit e tregut të kapitalit.

**(iii) Risku i normës së interesit**

Detyrimet e Shoqërisë që mbartin interes lidhen me kreditë e marra nga aksioneri dhe të ardhurat e Shoqërisë dhe flukset monetare operative nuk janë të ekspozuara në mënyrë të rëndësishme nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Norma e interesit e kredisë nga aksioneri është e fiksuar dhe ndonjë ndryshim në normat e interesit të tregut nuk do të kishte ndonjë efekt në pozicionin financiar të Shoqërisë.

**(iv) Risku i kredisë**

Shoqëria ndërmerr një ekspozim ndaj riskut të kredisë, i cili është risku që një palë në një instrument financiar mund të shkaktojë një humbje financiare për palën tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi.

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

Rreziku i kredisë lind nga mjetet monetare dhe ekuivalente me to, dhe nga depozitat në banka dhe institucionet financiare, si dhe nga ekspozimi i kredisë për klientët, duke përfshirë llogari të arkëtueshme dhe angazhime për transaksione.

Transaksionet bankare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 janë realizuar nëpërmjet bankës lokale, Raiffeisen Bank.

Në 31 dhjetor 2012, ka një risk minimal nga kreditë pasi Shoqëria ka llogari te arketueshme minimale.

**(v) Risku i likuiditetit**

Risku i likuiditetit përkufizohet si risku që një subjekt do të përballet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me detyrimet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj kërkesave ditore lidhur me burimet e saj monetare, kryesisht për të shlyer shpenzimet operative gjatë aktivitetit të saj rutinë. Drejtimi monitorin çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj parashikimin e vazhdueshëm të fluksit monetar të Shoqërisë.

Tabela më poshtë analizon aktivet dhe pasivet monetare financiare të Shoqërisë sipas maturimit të tyre bazuar në periudhën e mbetur në datën e raportimit deri në datën e maturimit kontraktual. Shumat e paraqitura në tabelë janë flukse monetare kontraktuale të paskontuara. Tepricat që shlyhen brenda 12 muajve barazojnë tepricat e mbartura pasi impakti i skontimit nuk është domethënës.

<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>Më pak se 3 muaj</b>	<b>Midis 3 - 6 muaj</b>	<b>Midis 6 muaj - 1 vit</b>	<b>Mbi 1 vit</b>	<b>Total</b>
<b>Aktive financiare</b>					
Llogari të arkëtueshme (shënimi 10)	1,056,608	-	-	-	1,056,608
Të arkëtueshme nga personeli (shënimi 10)	-	-	779,918	-	779,918
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente (shënimi 12)	22,948,433	-	-	-	22,948,433
	<b>24,005,041</b>	<b>-</b>	<b>779,918</b>	<b>-</b>	<b>24,784,959</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Huamarrje (shënimi 15)	(21,768,734)	-	-	(495,544,500)	(517,313,234)
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme (shënimi 17)	-	-	-	(992,985,472)	(992,985,472)
Tarifa e pagueshme e koncensionit (shënimi 18)	-	(16,586,168)	-	-	(16,586,168)
	<b>(21,768,734)</b>	<b>(16,586,168)</b>	<b>-</b>	<b>(1,488,529,972)</b>	<b>(1,526,884,874)</b>
<b>Risku i likuiditetit më 31 dhjetor 2012</b>	<b>2,236,307</b>	<b>(16,586,168)</b>	<b>779,918</b>	<b>(1,488,529,972)</b>	<b>(1,502,099,915)</b>
	<b>Më pak se 3 muaj</b>	<b>Midis 3 - 6 muaj</b>	<b>Midis 6 muaj - 1 vit</b>	<b>Mbi 1 vit</b>	<b>Total</b>
<b>Aktive financiare</b>					
Të arkëtueshme nga personeli (shënimi 10)	-	-	948,282	-	948,282
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente (shënimi 12)	11,541,791	-	-	-	11,541,791
	<b>11,541,791</b>	<b>-</b>	<b>948,282</b>	<b>-</b>	<b>12,490,073</b>
<b>Detyrime financiare</b>					
Huamarrje (shënimi 15)	-	(20,846,825)	-	(416,790,005)	(437,636,830)
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme (shënimi 17)	-	-	-	(754,885,345)	(754,885,345)
Të pagueshme personelit (shënimi 19)	(307,514)	-	-	-	(2,875,746)
	<b>(307,514)</b>	<b>(20,846,825)</b>	<b>-</b>	<b>(1,171,675,350)</b>	<b>(1,192,829,689)</b>
<b>Risku i likuiditetit më 31 dhjetor 2011</b>	<b>11,234,277</b>	<b>(20,846,825)</b>	<b>948,282</b>	<b>(1,171,675,350)</b>	<b>(1,180,339,616)</b>

Në datën e raportimit, aktivet monetare financiare të Shoqërisë konsistojnë në llogari të arkëtueshme dhe mjete monetare, ndërsa detyrimet monetare financiare përbëhen nga llogari të pagueshme, shpenzime të përlogaritura, pagat të pagueshme, si dhe hua afatgjata.

#### **4.2 Menaxhimi i riskut të kapitalit**

Menaxhimi i riskut të kapitalit nuk është relevant për operacionet e Shoqërisë. Shoqëria është krijuar vetëm për qëllimin e zbatimit të Marrëveshjes së Koncesionit. Sipas legjislacionit shqiptar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara duhet të ketë kontribute në kapital nga aksionerët por nuk kërkohet që të krijojë rezerva ligjore. Kapitali është kontribuar nga aksionarët në mjete monetare. Kapitali përfshin vetëm kapitalin e regjistruar, të paguar e të papaguar dhe Fitimet e Mbartura.

#### **4.3 Vlerësimi i vlerës së drejtë**

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një instrument financiar mund të shkëmbehet në një transaksion aktual midis palëve me vullnetin e tyre, dhe jo në një shitje ose likuidim të detyruar, dhe vërtetohet më mirë nga një çmim tregu aktiv i kuotuar në treg.

*Aktive financiare me kosto të amortizuar*

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme konsiderohet se përafron me vlerën kontabël pasi ato janë instrumente afatshkurtra.

*Detyrimet financiare me kosto të amortizuar*

Vlera kontabël e llogarive të pagueshme konsiderohet se përafron me vlerën e drejtë. Vlera e drejtë e huasë më 31 dhjetor 2012 ishte 518,430,233 Lek që rezultonte 1,116,999 Lek më shume se vlera kontabël neto (31 dhjetor 2011: 400,689,322 Lek që rezultonte 36,947,508 Lek më pak se vlera kontabël neto).

### **5 Vlerësime dhe gjykime kritike**

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen mbi eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë këtu pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Vlerësimet kontabël rezultuese, sipas përcaktimit, rrallë do të barazojnë rezultatet aktuale që kanë lidhje me to. Vlerësimet dhe supozimet që kanë një risk domethënës për të shkaktuar një ndryshim material tek shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar trajtohen më poshtë.

#### **Tatimi mbi fitimin**

Shoqëria i nënshtrohet tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Gjykim i rëndësishëm kërkohet për të përcaktuar shumën e tatimit mbi fitimin të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurt. Shoqëria i njej detyrimet për kontrollin paraprak të tatimeve bazuar në vlerësimet nëse do të ketë detyrime për tatime shtesë. Nëse rezultati përfundimtar i tatimit për këto çështje është i ndryshëm nga shumat që janë regjistruar në fillim, këto ndryshime do të ndikojnë aktivet dhe detyrimet aktuale dhe të shtyra të tatimit mbi fitimin në periudhën në të cilën është bërë ky përcaktim.

#### **Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale**

Vlerësimi i jetëgjatësisë së aktiveve afatgjata materiale është një çështje gjykimi e bazuar në eksperiencë me aktive të tjera të ngjashme. Përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktive konsumohen së pari përmes përdorimit. Gjithsesi, faktorë të tjerë, siç janë konsumimi nga pikpamja teknike dhe komerciale si dhe vjetërimi, shpesh rezultojnë në pakësimin e përfitimeve ekonomike të trupëzuara në aktive.

Drejtimi vlerëson jetëgjatësinë e mbetur në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periudhën e llogaritur gjatë së cilës ato priten të sjellin përfitime për Shoqërinë. Faktorët kryesorë të mëposhtëm janë marrë në konsideratë:

(a) përdorim i pritshëm i aktiveve;

(b) vjetërimi i pritshëm fizik, i cili varet nga faktorët operacionalë dhe programi i mirëmbajtjes; dhe

(c) dalja nga përdorimi për sa i përket anës teknike dhe komerciale që lind nga ndryshimet në kushtet e tregut.

#### **Parimi i vijimësisë**

Drejtimi i ka përgatitur këto pasqyra financiare mbi bazën e parimit të vijimësisë. Në këtë gjykim drejtimi ka konsideruar pozicionin financiar të Shoqërisë, qëllimet aktuale, përfitueshmërinë operative dhe aksesin në burimet financiare, si dhe ka analizuar impaktin e krizës financiare të kohëve të fundit lidhur me veprimtarinë e mëtejshme të Shoqërisë.

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

---

*(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

Shoqëria ka kapital neto negativ në një vlerë neto prej 301,933,609 Lek (2011: 221,141,774 Lek), por ka hua dhe detyrime ndaj shoqërive SICPA që arrin në një vlerë totale prej 1,507,065,492 Lek (2011: 1,184,376,901 Lek) (shënimi 31). Drejtuesit e Grupit kanë deklaruar angazhimin e tyre për të vazhduar mbështetjen e Shoqërisë.

Marrëveshja e Koncesionit do të hyjë në fuqi më 6 shkurt 2013 dhe për këtë arsye, Shoqëria nuk ka për qëllim t'i nënshtrohet likuidimit ose të ndërpresë veprimtarinë e saj gjatë vitit 2013.

***Njohja e aktivitetit të shtyrë***

Aktivi tatimor i shtyrë i njohur përfaqëson tatimet mbi fitimin që përfitohen përmes zbritjeve të ardhshme nga fitimet e tatueshme dhe regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar. Aktivi tatimor i shtyrë njihet deri në atë masë që realizimi i përfitimit të tatimit është i mundshëm. Fitimet e tatueshme dhe shumat e përfitimeve tatimore që janë të mundshme në të ardhmen bazohen në planin biznesin afatmesëm të përgatitur nga drejtimi dhe rezultatet e ekstrapoluara prej tij për vitet 2013 dhe 2014. Plani i biznesit bazohet në pritshmëritë e drejtimit të cilat besohet se janë të arsyeshme duke konsideruar kushtet aktuale.

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**6 Aktive afatgjata materiale**

	Përmirësime të ambienteve me qira	Instalime	Komputera dhe pajisje zyre	Makineri e pajisje teknike	Aktive në proces	Pjesë këmbimi e pajisje kryesore rezervë	Total
<b>Kosto</b>							
Më 1 janar 2011	-	-	-	-	-	-	-
Shtesa	33,014,404	7,948,623	18,812,697	-	166,650,087	359,106,638	585,528,449
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2011</b>	<b>33,010,404</b>	<b>7,948,623</b>	<b>18,812,697</b>	-	<b>166,650,087</b>	<b>359,106,638</b>	<b>585,528,449</b>
Shtesa për vitin	2,863,067	12,115,033	19,715,557	387,422,557	-	-	422,116,214
Riklasifikim në inventar	-	-	-	-	-	(5,477,041)	(5,477,041)
Riklasifikim në aktive të mbajtura për shitje	-	-	-	-	-	(44,281,515)	(44,281,515)
Riklasifikim në shpenzime	-	-	-	-	-	(488,977)	(488,977)
Riklasifikime ndërmjet AAM	-	-	-	475,509,192	(166,650,087)	(308,859,105)	-
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>35,873,471</b>	<b>20,063,656</b>	<b>38,528,254</b>	<b>862,931,749</b>	-	-	<b>957,397,130</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>							
Më 1 janar 2011	-	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	(891,992)	(226,203)	(2,754,894)	-	-	-	(3,873,089)
<b>Më 31 dhjetor 2011</b>	<b>(891,992)</b>	<b>(226,203)</b>	<b>(2,754,894)</b>	-	-	-	<b>(3,873,089)</b>
Amortizimi i vitit	(16,558,396)	(3,496,268)	(7,793,754)	(119,101,361)	-	-	(146,949,779)
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>(17,450,388)</b>	<b>(3,722,471)</b>	<b>(10,548,648)</b>	<b>(119,101,361)</b>	-	-	<b>(150,822,868)</b>
<b>Vlera neto</b>							
Më 1 janar 2011	-	-	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2011</b>	<b>32,118,412</b>	<b>7,722,420</b>	<b>16,057,803</b>	-	<b>166,650,087</b>	<b>359,106,638</b>	<b>581,655,360</b>
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>18,423,083</b>	<b>16,341,185</b>	<b>27,979,606</b>	<b>743,830,388</b>	-	-	<b>806,574,262</b>

Më 31 dhjetor 2011 Shoqëria njohu si "Aktive në proces" pajisje që ishin në procesin e instalimit dhe montimit dhe si "Pjesë këmbimi e pajisje kryesore rezervë" pajisje që priteshin t'i nënshtroheshin proceseve të instalimit gjatë vitit 2012. Shoqëria nuk llogariti amortizim për aktivet e klasifikuara si "Aktive në proces" dhe "Pjesë këmbimi e pajisje kryesore rezervë" meqenëse ato nuk ishin ende të gatshme për përdorim. Gjatë vitit 2012, pjesa më e madhe e tyre u instaluan e u montuan dhe u klasifikuan në kategorinë "Makineri e pajisje teknike". Shoqëria filloi amortizimin e tyre në momentin kur këto aktive ishin të gatshme për përdorim dhe hynë në procesin e prodhimit të Pullave Ffiskale. Ndërsa një pjesë e vogël e tyre u riklasifikuan si inventar, aktive afatgjata të mbajtura për shitje si dhe shpenzime, në bazë të natyrës dhe përdorimit të tyre të pritsëm.

Shoqëria njohu në vitin 2011 një provizion në shumën 564,529 Lek në lidhje me kostot e pritshme të çmontimit të instalimeve në ambjentet e marra me qira (shënimi 16). Provizioni është matur me vlerën aktuale të shpenzimeve të pritshme, skontuar me normën e interesit të huasë dhe është përfshirë në klasën e aktiveve "Përmirësime të ambienteve me qira".

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**7 Aktive afatgjata jomateriale**

	Programme kontabiliteti	Totali
<b>Kosto</b>		
Më 1 janar 2011	-	-
Shtesa	182,260	182,260
Pakësime	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2011</b>	<b>182,260</b>	<b>182,260</b>
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>182,260</b>	<b>182,260</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>		
Më 1 janar 2011	-	-
Amortizimi i vitit	(18,985)	(18,985)
Pakësime	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2011</b>	<b>(18,985)</b>	<b>(18,985)</b>
Amortizimi i vitit	(45,565)	(45,565)
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>(64,550)</b>	<b>(64,550)</b>
<b>Vlera neto</b>		
Më 1 janar 2011	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2011</b>	<b>163,275</b>	<b>163,275</b>
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>117,710</b>	<b>117,710</b>

**8 Aktive tatimore të shtyra**

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Aktive tatimore të shtyra	14,574,551	22,415,065
Detyrime tatimore të shtyra	-	-
<b>Aktive tatimore të shtyra neto</b>	<b>14,574,551</b>	<b>22,415,065</b>

Lëvizja në tatimin e shtyrë është si më poshtë:

<b>Më 1 janar 2011</b>	-
E ardhura nga tatimi i shtyrë	(22,415,065)
<b>Më 31 dhjetor 2011</b>	<b>(22,415,065)</b>
Shpenzim i tatimit të shtyrë	7,840,514
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>(14,574,551)</b>

Aktivet tatimore të shtyra janë njohur për shpenzimet e nisjes, të cilat njihen si aktive afatgjata për qëllime fiskale, humbjen fiskale, rënien e vlerës së inventarit, provizionin për kostot e çmontimit si dhe të tjera shpenzime të përlogaritura si më poshtë:

Aktive tatimore të shtyra	AMM	Humbje fiskale	Inventar	Provizion	Detyrime të tjera	Total
Më 1 janar 2011	-	-	-	-	-	-
Kredituar në fitime ose humbje	5,307,678	16,789,720	-	57,249	260,418	22,415,065
<b>Më 31 dhjetor 2011</b>	<b>5,307,678</b>	<b>16,789,720</b>	-	<b>57,249</b>	<b>260,418</b>	<b>22,415,065</b>
Kredituar/(ngarkuar) në fitime ose humbje	771,266	(9,789,720)	680,514	402	497,024	(7,840,514)
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>6,078,944</b>	<b>7,000,000</b>	<b>680,514</b>	<b>57,651</b>	<b>757,442</b>	<b>14,574,551</b>

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

<b>Detyrime tatimore të shtyra</b>	<b>AMM</b>	<b>Inventar</b>	<b>Provizion</b>	<b>Detyrime të tjera</b>	<b>Total</b>
Më 1 janar 2011	-	-	-	-	-
Ngarkuar në fitime ose humbje	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2011</b>	-	-	-	-	-
Ngarkuar në fitime ose humbje	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	-	-	-	-	-

Në bazë të legjislacionit shqiptar humbjet fiskale mund të mbarten deri në tre vitet pasardhëse. Aktiviteti tatimor i shtyrë për humbjen fiskale të mbartshme është njohur deri në nivelin që realizimi i përfitimeve fiskale të lidhura me humbjet e mbartshme nëpërmjet fitimeve të ardhshme fiskale është i mundur.

Shoqëria njohu tatim të shtyrë aktiv në vlerën prej 7,000,000 Lek (2011: 16,789,720 Lek) në lidhje me humbjet fiskale prej 70,000,000 Lek të cilat pritet të zbriten ndaj fitimeve fiskale për vitet 2013 dhe 2014 të vlerësuara bazuar në planin afatmesëm të përgatitur nga drejtimi i Shoqërisë.

Shoqëria nuk njohu tatim të shtyrë aktiv prej 7,085,249 Lek (2011: zero) në lidhje me humbjet fiskale prej 70,852,491 Lek që mund të mbarteshin në vitet 2013 dhe 2014, sepse nuk pret të gjenerojë fitime të mjaftueshme gjatë viteve 2013 dhe 2014 kundrejt të cilave të përdorë këtë humbje të mbartur.

Humbjet e mbartura të papërdorura në vlerën prej 140,852,491 Lek të mbartura prej vitit 2011 skadojnë në vitin 2014.

**9 Inventari**

	<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>31 dhjetor 2011</b>
Lëndët e para dhe të konsumit	98,314,673	172,255,478
Produkte të gatshme	90,516,732	20,611,941
Minus: Rënie në vlerë (shënimi 24)	(6,805,138)	-
<b>Totali</b>	<b>182,026,267</b>	<b>192,867,419</b>

**10 Parapagime dhe të tjera të arkëtueshme**

	<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>31 dhjetor 2011</b>
Tatimi mbi vlerën e shtuar i arkëtueshëm	165,427,215	162,562,942
Parapagime për shërbime	4,750,441	5,107,435
Llogari të arkëtueshme	1,056,608	-
Parapagime për personelin	779,919	948,282
<b>Totali</b>	<b>172,014,183</b>	<b>168,618,659</b>

**11 Tatim fitimi i parapaguar**

Vlera prej 771,250 Lek në datën 31 dhjetor 2012 (31 dhjetor 2011: 171,250 Lek) përfaqëson totalin e parapagimeve të tatimit mbi fitimin deri në atë datë.

**12 Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente**

	<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>31 dhjetor 2011</b>
Mjete monetare në arkë:		
Në Lek	43,735	43,053
Në Euro	-	-
	<b>43,735</b>	<b>43,053</b>
Mjete monetare në bankë:		
Llogari rrjedhëse		
Në Lek	684,523	5,916,828
Në Euro	22,220,175	5,581,910
	<b>22,904,698</b>	<b>11,498,738</b>
<b>Totali</b>	<b>22,948,433</b>	<b>11,541,791</b>

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***13 Aktive afatgjata të mbajtura për shitje**

Aktivet afatgjata të mbajtura për shitje në vlerën prej 44,281,515 Lek (31 Dhjetor 2011: zero) përfshijnë pjesë këmbimi e pajisje kryesore rezervë që nuk janë instaluar dhe futur në përdorim gjatë vitit 2012 dhe për të cilat u vendos të ktheheshin te SICPA Security Solutions SA (furnitori). Ato janë lëvruar në shkurt 2013.

**14 Humbje të akumuluar**

	2012	2011
Më 1 janar	(227,941,774)	61,695,135
Humbja e vitit	(80,791,835)	(166,246,639)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>(308,733,609)</b>	<b>(227,941,774)</b>

**15 Huatë**

Më 31 dhjetor 2012 dhe 2011, huatë janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Afatgjatë:		
Hua nga SICPA Holding SA	495,544,500	416,790,005
Afatshkurtër:		
Interesa dhe tarifa angazhimi të përlogaritura	21,768,734	20,846,825
<b>Totali</b>	<b>517,313,234</b>	<b>437,636,830</b>

Një hua me vlerë 4 milion Euro i është dhënë Shoqërisë nga SICPA Holding SA për t'u disbursuar në transhe. Huaja fillimisht kishte maturitet dy vjeçar dhe ishte e ripagueshme brenda datës 11 mars 2013. Gjatë vitit 2012 u nënshkrua një amendim i kontratës dhe u aprovua një shtyrje e ripagimit të kredisë për 2 vite të tjera. Data e rishikuar e pagesës së kredisë është 19 prill 2015.

Huaja është marrë në EUR dhe mbart një normë interesi prej 8.43% në vit. Mbi shumën e padisbursuar të kredisë përlogaritet dhe paguhet një tarife angazhimi prej 1.3%.

**16 Provizionet**

	Kostot e çmontimit	Totali
Më 1 janar 2011	-	-
Provizioni i ngritur	564,529	564,529
Efekti i skontimit të provizionit	7,959	7,959
<b>Më 31 dhjetor 2011</b>	<b>572,488</b>	<b>572,488</b>
Efekti i skontimit të provizionit	4,021	4,021
<b>Më 31 Dhjetor 2012</b>	<b>576,509</b>	<b>576,509</b>

Provizionet lidhen me kostot e çmontimit për ambjentet e marra me qira. Provizioni matet me vlerën aktuale të shpenzimeve të pritshme, skontuar me normën e interesit të huasë.

**17 Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme**

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
SICPA Security Solutions S.A.	985,131,988	746,740,071
SICPA Management	4,620,270	-
Furnitorë të tjerë	3,233,214	8,145,274
<b>Totali</b>	<b>992,985,472</b>	<b>754,885,345</b>

**18 Tarifa e koncensionit**

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Më 1 janar	-	-
Pagesa gjatë vitit	-	-
Tarifa e koncensionit për vitin	16,586,168	-
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>16,586,168</b>	<b>-</b>



**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

Duke ju referuar Aneksit 18 të Marrëveshjes së Konkensionit, Shoqëria detyrohet t'i paguajë Autoritetit një tarifë konkensionit prej 2% të totalit vjetor të shitjeve të pullave fiskale. Prodhimi dhe shitja e pullave fiskale ka filluar prej 2012, dhe pse Marrëveshja e Konkensionit nuk konsiderohej ende plotësisht efektive. Shoqëria ka njohur në këto pasqyra financiare një përllogaritje në vlerën e 16,586,168 Lek (2011: nil) për tarifën e konkensionit për vitin 2012, e cila pritet të bëhet e pagueshme njëherë që Marrëveshja e Konkensionit do të hyjë në fuqi.

**19 Detyrime të tjera**

	<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>31 dhjetor 2011</b>
Shpenzime të përllogaritura	11,764,098	2,604,184
Detyrime tatimore lidhur me personelin	5,030,274	2,538,713
Paga të pagueshme	-	307,514
Të ardhura të shtyra	283,814	-
Taksa të tjera	702,211	29,519
<b>Totali</b>	<b>17,780,397</b>	<b>5,479,930</b>

Shpenzime të përllogaritura në vlerën e 11,764,098 Lek (2011: 2,604,184 Lek) konsistojnë kryesisht në bonuse të përllogaritura për punonjësit, komisione garancie bankare të përllogaritura dhe shpenzime të përllogaritura për shërbime profesionale dhe utilitete.

Të ardhura të shtyra në vlerën prej 283,814 Lek (2011: zero) konsistojnë në shitje të cilat u janë faturuar klientëve por nuk janë njohur ende si të ardhura sepse data e lëvrimit të mallrave drejt klientit është pas 31 dhjetorit 2012.

**20 Të ardhura operative**

	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011</b>
Shitja e mallrave	829,039,608	-
Të ardhura nga transporti i mallrave të shitura	31,317,222	-
<b>TOTAL</b>	<b>860,356,830</b>	<b>-</b>

**21 Kosto e mallrave të shitur**

	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012</b>	<b>Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011</b>
Kosto e mallrave të shitura	379,786,639	-
Kosto e transportit të mallrave të shitura	31,317,222	-
<b>TOTAL</b>	<b>411,103,861</b>	<b>-</b>

Shoqëria ka përllogaritur koston e mallrave të shitura duke përdorur metodën e koston standarde. Diferencat periodike janë analizuar nga kompania për të bërë krahasimin e koston aktuale me koston standarde dhe nga ky krahasim nuk kanë rezultuar diferenca të rëndësishme.

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***22 Furnizime dhe shërbime**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Shërbime mbështetëse nga SICPA Security Solutions SA	25,651,813	-
Shpenzime qeraje	17,352,108	18,227,558
Shpenzime udhëtimi	14,843,347	29,187,903
Taksa doganore dhe taksa lokale	11,821,814	7,368,698
Shpenzime qeraje për automjete	5,609,983	2,184,795
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	4,890,437	1,547,095
Shpenzime mirëmbajtjeje	4,670,402	1,332,095
Shpenzime konsulence	3,537,129	47,367,306
Shpenzime sigurimi	3,037,947	1,130,772
Shpenzime për energji elektrike, ujë, gaz etj	2,599,572	456,865
Shpenzime përfaqësimi	1,583,126	984,371
Shërbime profesionale	1,531,318	986,403
Shpenzime rekrutimi	589,000	6,192,428
Shpenzime të tjera	11,894,608	13,559,238
Shpenzime për materiale	-	1,406,948
Komisione bankare	-	187,804
<b>Totali</b>	<b>109,612,602</b>	<b>132,120,279</b>

**23 Shpenzime për personelin**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Pagat	127,594,007	51,326,397
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	6,245,607	3,684,105
<b>Totali</b>	<b>133,839,614</b>	<b>55,010,502</b>

**24 Rënia në vlerë e inventarit**

Shoqëria ka njohur një pakësim të vlerës së inventarit prej 6,805,138 Lek si provizion për inventarin e identifikuar si skrap më 31 dhjetor 2012 (2011: zero).

**25 Nxjerrje jashtë përdorimit të inventarit**

Shoqëria ka nxjerrë jashtë përdorimit vlerën e inventarit prej 8,371,530 Lek i cili konsiston në inventar të prodhuar jashtë standardeve të kërkuara si dhe inventar të përdorur për testime të instalimit të pajisjeve dhe makinerive prodhuese (2011: zero).

**26 Honorare për të drejtat e autorit**

Honorare për të drejtat e autorit prej 43,707,641 Lek u përlogaritën nga total i të ardhurave nga shitja dhe janë të pagueshme ndaj shoqërisë mëmë SICPA Security Solutions SA për të drejtat për të përdorur emrin tregtar, proceset e planifikimit dhe prodhimit si dhe në lidhje me informacione që kanë lidhje me eksperiencën tregtare dhe industrial përdorur gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2012 (2011: zero).

**27 (Humbje) / fitime të tjera neto**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Fitime të realizuara nga kursi i këmbimit	13,315,168	28,295,166
Fitime të porealizuara nga kursi i këmbimit	28,315,815	360,338
	<b>41,630,983</b>	<b>28,655,504</b>
Humbje nga këmbimi nga aplikimi i metodës së kostos standarde	(5,371,606)	-
Humbje të realizuara nga kursi i këmbimit	(5,689,735)	(91,632)
Humbje të porealizuara nga kursi i këmbimit	(41,348,603)	(5,006,875)
	<b>(52,409,944)</b>	<b>(5,098,507)</b>
<b>Fitime të tjera neto</b>	<b>(10,778,961)</b>	<b>23,556,997</b>

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.**

**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**28 Shpenzime financiare neto**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Të ardhura financiare :		
Të ardhura nga interesi i llogarive bankare	19,071	96,405
	<b>19,071</b>	<b>96,405</b>
Shpenzime financiare:		
Interesa dhe tarifa të angazhimit mbi huatë	(42,431,407)	(20,846,825)
Efektet e skontimit të provizionit	(4,021)	(7,959)
Komisione për garanci bankare e të tjera	(3,090,935)	(437,467)
	<b>(45,526,363)</b>	<b>(21,292,251)</b>
<b>Totali</b>	<b>(45,507,292)</b>	<b>(21,195,846)</b>

**29 (Shpenzim)/e ardhur e tatimit mbi fitimin**

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Shpenzime për tatimin mbi fitimin aktual (Shpenzim)/e ardhur nga tatimi i shtyrë	- (7,840,514)	- 22,415,065
<b>Totali</b>	<b>(7,840,514)</b>	<b>22,415,065</b>

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin aktual për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 janë zero (2011: zero) pasi Shoqëria rezultoi me humbje fiskale. Përqindja e tatimit mbi fitimin për vitin 2012 është 10% (2011: 10%).

**Rakordimi i normës efektive të tatimit**

	Norma efektive e tatimit mbi fitimin	2012	Norma efektive e tatimit mbi fitimin	2011
Humbja para tatimit për vitin		(72,951,321)		(188,661,704)
Tatimi mbi fitimin me normën standarde	10.00%	(7,295,132)	10%	(18,866,170)
Rregullime:				
Shpenzimet e nisjes	1.27%	(925,141)	0.49%	(925,141)
Ndryshimi midis amortizimit kontabël dhe fiskal	(2.18%)	1,592,849	(0.04%)	75,852
Provizioni për kostot e çmontimit	0.00%	402	0.00%	796
Shpenzime të perlllogaritura	(1.04%)	757,041	(0.13%)	248,937
Rënia në vlerë e inventarit	(0.93%)	680,514	0.00%	-
Shpenzime të pazbritshme	(10.63%)	7,757,386	(1.42%)	2,676,006
<b>Rezultati fiskal</b>	<b>(3.52%)</b>	<b>2,567,918</b>	<b>8.90%</b>	<b>(16,789,720)</b>
(Përdorimi)/njohja e humbjeve fiskale të mbartshme.	3.52%	(2,567,918)	(8.90%)	16,789,720
Efkti i diferencave të përkohshme (të ndryshme nga humbja fiskale)	(2.67%)	1,949,206	(2.98%)	5,625,345
Efkti i vetë-korrigjimit të humbjes fiskale të vitit 2011	0.19%	(136,553)	-	-
Efkti i mosnjohjes së humbjes fiskale të mbartshme	9.71%	(7,085,249)	-	-
<b>Tatimi mbi fitimin</b>	<b>10.75%</b>	<b>(7,840,514)</b>	<b>(11.88%)</b>	<b>22,415,065</b>

Sipas legjislacionit shqiptar humbja fiskale mund të mbartet deri në tre vitet pasardhëse. Humbjet fiskale të gjeneruara gjatë vitit 2011 në vlerën prej 167,897,202 Lek janë përdorur pjesërisht ndaj fitimeve fiskale të vitit 2012 në vlerën prej 25,679,185 Lek.

Në 25 mars 2013, Shoqëria dorëzoi një kërkesë për korrigjimin e tatimit të fitimit të vitit 2011 duke reduktuar humbjen fiskale të deklaruar të vitit 2011 me 1,365,526 Lek.

Pjesa e papërdorur dhe e korrigjuar e humbjes fiskale të mbartur nga viti 2011 në shumën 140,852,491 Lek do të mbartet në vitet 2013 dhe 2014. Drejtimi i Shoqërisë pret të përdorë nga kjo vlerë afërsisht vetëm 70,000,000 Lek kundrejt fitimeve të pritshme fiskale të viteve 2013 dhe 2014.

**30 Angazhime, garanci dhe detyrime të mundshme**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime dhe procese gjyqësore të ndryshme. Drejtimi i Shoqërisë është i mendimit se kosto përfundimtare e zgjidhjes së këtyre çështjeve nuk do të ketë një efekt material në pozicionin financiar të Shoqërisë apo ndryshimin në aktivet neto, përveç rasteve të prezantuara në këto pasqyra financiare.

**Detyrime të mundshme tatimore**

Legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri në fuqi ose që konsiderohet si i hyrë në fuqi në fund të periudhës raportuese, është objekt i interpretimeve të ndryshme për sa i përket zbatimit të tij për transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor ndërmarrë nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbështet qëndrimet tatimore mund të kundërshtohet me sukses nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga autoritetet për pesë vite kalendarike para vitit të shqyrtimit. Nën rrethana të caktuara shqyrtimet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

**Angazhime kapitale**

Shoqëria nuk ka pasur shpenzime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara në datën e raportimit.

**Angazhime të qerasë operationale**

Më 31 dhjetor 2012 Shoqëria ka hyrë në angazhime kontraktuale qeraje për ambientet e zyrave dhe operationeve. Qeraja që pritej të përfundonte në shkurt 2013, u shty deri në 1 shkurt 2014, nëse palët nuk bien dakord ndryshe.

Pagesat minimale të ardhshme për qeranë operative janë si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>31 dhjetor 2011</b>
Jo më vonë se 1 vit	16,655,930	19,063,624
Më vonë se 1 vit dhe jo më vonë se 5 vjet	1,369,068	3,177,271
Më vonë se 5 vjet	-	-

**31 Transaksionet me palët e lidhura**

Palët konsiderohen të jenë palë të lidhura nëse një palë ka mundësinë të kontrollojë ose të ushtrojë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operationale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë.

Në palët e lidhura me shoqërinë përfshihen SICPA Holding SA, SICPA Security Solutions SA dhe SICPA Management të cilët janë pjesë e grupit të shoqërive SICPA.

Shoqëria ka kryer transaksione me palët e lidhura gjatë rrjedhës normale të biznesit. Volumi i këtyre transaksioneve dhe teprica e mbetur në fund të periudhave respektive është si më poshtë:

**Detyrimet ndaj palëve të lidhura**

	<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>31 dhjetor 2011</b>
Pjesa afatgjatë		
SICPA Holding (shënimi 15)	495,544,500	416,790,005
	495,544,500	416,790,005
Pjesa afatshkurtër		
SICPA Holding SA (shënimi 15)	21,768,734	20,846,825
SICPA Security Solution SA (shënimi 17)	985,131,988	746,740,071
SICPA Management (shënimi 17)	4,620,270	-
	1,011,520,992	767,586,896
<b>Totali</b>	<b>1,507,065,492</b>	<b>1,184,376,901</b>

**SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***Volumi i transaksioneve me palët e lidhura**

<b>Shpenzime</b>	<b>31 dhjetor 2012</b>	<b>31 dhjetor 2011</b>
Honorare për të drejtat e autorit (shënimi 26)	43,707,641	-
Tarifa e menaxhimit/shërbime personeli (shënimi 23)	43,422,610	30,548,397
Interesa huaje dhe tarifa angazhimi (shënimi 28)	42,431,407	20,846,825
Shërbime mbështetëse	25,651,813	-
Shërbime trajnimi	4,620,270	-
Komisione garancie	2,475,968	3,183,343
Tarifa ligjore	-	35,196,964
Procedura publikimi	-	4,243,801
<b>Totali</b>	<b>162,309,709</b>	<b>94,019,330</b>

**32 Ngjarje pas datës së raportimit**

Marrëveshja e Koncesionit u bë tërësisht efektive më 6 shkurt 2013. Drejtimi i Shoqërise nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër të ndodhur pas datës së raportimit, e cila mund të kërkonte rregullime apo shënime shtesë në këto pasqyra financiare.